



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:057703

Datë: 24.09.2021

Numri i dokumentit: 02208341

C.nr.153/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj dhe sekretarin juridik Xhavit Morina në çështjen juridike të paditësit, Kompania për D. dhe F. me E.E. Sh.a. (K.) me seli në P. Rr “B. B. K. nr.... N. e E. Kati ... numër ...,P. ..., Republika e Kosovës, kundër të paditurit S. (G.) G. nga fshati C. Komuna e Malishevës, për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera: **393.47 Euro**, me datën **24.09.2021**, mori këtë:

A K T G J Y K I M
për shkak të pa dëgjueshmërisë/ mosbindjes

MIRATOHET padia dhe kërkesë-padia e paditësit, K. për D. dhe F. me E. E. Sh.a. (K.) me seli në P., në tërësi **si e bazuar**.

DETYROHET i padituri S. (G.) G. nga fshati C. K. e M., t’ia kompensoj shumën prej 393.47 €, (treqind e nëntëdhjetë e tre euro e katërdhjetë e shtatë cent) për dëmin e shkaktuar material ndaj paditëses, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga nxjerrja e Aktgjykimit datës **24.09.2021** e deri në përmbushjen definitive të detyrimit si dhe shpenzimet procedurale në shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 (ditësh) pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi me datë 19.03.2021, në këtë Gjykatë ka parashtruar padinë kundër të paditurit, për shkak të kompensimit të dëmit material në vlerë prej 393.47 €, duke theksuar ndër tjerash se i padituri deri me datë 26.04.2017, me qëllim që vetit të i sjell pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që jashtë njehsorit elektrik përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këto veprime energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar. Me veprimin e tij i Padituri, i ka shkaktuar Paditëses dëmin material në vlerë prej 393.47 euro.

Sipas Aktgjykimit Penal të formës së prerë të Gjykatës Themelore të Gjakovës, dega në Malishevë P.nr.35/18 të datës 21.05.2019 i cili ka marrë formën e prerë me datën 24.07.2019, I padituri është shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përderisa e dëmtuara, tani Paditësi për kompensimin e dëmit të shkaktuar në lidhje me veprën e lartpërmendur penale është udhëzuar në kontest civil.

Gjykata në kuptim të nenit 394, 395 al.1 dhe 2 të Ligjit të procedurës kontestimore i ka dërguar të paditurit padinë, provat materiale dhe aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi.

Duke e bërë shikimin në fletë dërgesë për dorëzimin personal konstatohet se me datë 01.06.2021 aktvendimi i datës 12.05.2021 dhe padia me provat materiale paditësit i është *dorëzuar personalisht*, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjigjes në padi, i njëjti nuk e ka parashtruar përgjigjën në padi, andaj duke u bazuar në dispozita ligjore të nenit 150 al.1 pika (a),(b) dhe (c), të LPK-së të lartë cituar, Gjykata mori Aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet si më poshtë vijojnë:

- a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregull padia, provat materiale dhe thirrja- Aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi,
- b) Themelësia e kërkesë padisë rezulton nga faktet e treguar në padi, dhe
- c) Faktet mbi të cilat mbështet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 452 paragraf.1 të LPK-së me ç'rast palës paditëse i janë pranuar shpenzimet në emër të taksës gjyqësore për padi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-DEGA NË MALISHEVË
Departamenti i përgjithshëm Divizioni Civil
C.nr.153/21 e datës 24.09.2021

GJYQTARI
Nehat Qelaj

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimit është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në afat brenda 15 dite nga dita e pranimit të së njëjtit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.